

AKADEMIA E SIGURISE
SENATI AKADEMIK

Nr./*o.p.* Prot.

Tiranë më 02 Maj 2023

VENDIM Nr. 79


Senati i Akademisë së Sigurisë i mbledhur sot më datën 02.05.2023, mbasi diskutoi, në lidhje me ndryshimet e përmbajtjes dhe formës së Diplomës dhe Supplementit të Diplomës së programit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat vijnë si rezultat i ndryshimeve në Statutin e ri të Akademisë së Sigurisë, të miratuar me urdhërin e përbashkët Nr.130 datë 10.03.2023, të Ministrisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Brendshme, Udhëzimit nr. 11, date 02.04.2020 të MAS "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Supplementit të diplomës" si dhe në respektim të ligjit "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve të përmbajtjes dhe formës së Diplomës së programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Siguria dhe Hetimi", të propozuar nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit.
2. Miratimin e përmbajtjes dhe formës së Supplementit të Diplomës së programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Siguria dhe Hetimi", të propozuar nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit.
3. Kopje e këtij vendimi dhe formatet e reja të Diplomës dhe Supplementit të Diplomës së programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Siguria dhe Hetimi", ti dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Bashkëlidhur, përmbajtja dhe format e reja të Diplomës dhe Supplementit të Diplomës për programin e ciklit të parë "Bachelor" në "Siguria dhe Hetimi".

Kryetari i Senatit
Prof. Dr. Ilirjan MANDRO



Tiranë 02.05. 2023